

# Udhëzues për... krijimin e një klubi shkrimtarësh

Një klub shkrimtarësh mund të bëhet edhe vetëm nga ti dhe një fqinj që takoheni së bashku herë pas here dhe flisni për shkrimet tuaja duke pirë një çaj; ose mund të bëhet me një grup më të madh me miq e të afërm; mund të ketë ndonjë grup të tillë lokal që takohet në bibliotekën e qytetit me të cilët mund të bashkohesh. Zgjidh atë që funksionon më mirë për ty.

## CILI ËSHTË QËLLIMI I NJË KLUBI SHKRIMTARËSH?

Të bëhesh pjesë e një klubi shkrimtarësh është shumë e bukur nëse:

- Kërkon motivim për të shkruar
- Kërkon të fitosh besim te aftësitë e tua për të shkruar
- Dëshiron të shpjegosh idetë e tua për një tregim ose histori për të cilën po punon
- Dëshiron të takohesh me njerëz që mendojnë si ti
- Dëshiron të gjesh ide të reja dhe frymëzim për punën tënde.

## SI TA KRIJOJ NJË GRUP TË TILLË?

Për të krijuar një grup të tillë, mund të veproni si më poshtë:

- Flisni me miqtë dhe të afërmit për të parë nëse ndonjë prej tyre është i interesuar të shkruajë. Mund të zbulosh se disa prej tyre kanë vite që dëshirojnë të merren me shkrime – ose kanë vite që shkruajnë! Ftojti në shtëpi ndonjë mbrëmje apo pasdite.
- Nëse je pjesë e ndonjë klubi social, pyet nëse mund të vendosësh një njoftim në tabelën e njoftimeve për t'u treguar njerëzve që po krijojnë një klub shkrimtarësh.
- Kontrollon nëse në bibliotekën e qytetit ekziston ndonjë klub leximi. Sido që të jetë, mund të jetë gjë e bukur të bashkohesh me ta, dhe anëtarët e një klubi leximi ka të ngjarë të jenë të interesuar edhe për të shkruar.

- Ose, kontrollon nëse biblioteka e qytetit ose qendra kulturore dëshirojnë të hapin një klub shkrimtarësh, nëse nuk e kanë një të tillë. Nëse ke gjetur disa persona të interesuar, personeli i bibliotekës mund t'ju lërë me kënaqësi të përdorni ambientet e tyre si vend takimi, dhe të vendosni lajmërim për persona të tjerë që dëshirojnë të bashkohen me ju.

## TAKIMI I PARË I KLUBIT

Nuk ka ndonjë rregull të caktuar për të pasur një klub shkrimtarësh. E rëndësishme është që të gjithë pjesëtarët e grupit të jenë të kënaqur e të relaksuar.

Nëse takoheni nëpër shtëpi, servirni çaj ose biskota, ose diçka tjetër sipas preferencës. Edhe nëse takoheni në bibliotekë, merrni ndonjë patatinë a diçka të ngjashme me vete. Truri krijues duhet ushqyer!

Vendosni se sa të gjata do të jenë takimet dhe përmbajuni këtij orari. Një deri në dy orë është orari më i përshtatshëm, në varësi të përmasave të grupit. Përpiquni që askush të mos ju shqetësojë. Sigurohuni edhe që të gjithë të kenë stilolaps e letër.

Nëse klubin e filloni me një grup me njerëz të rinj, në fillim prezantohuni. Kërkojuni të gjithëve të thonë emrin, diçka komike për veten dhe se çfarë kërkojnë të përfitojnë si pjesë e këtij grupi.

Nëse të gjithë jeni të njohur, tregojini njëri-tjetrit kujtimet që keni për shkrimet e para. Si ishte kjo eksperiencë, pozitive, negative apo neutrale? Çfarë ndikimi kanë pasur këto përvoja të hershme në mënyrën tënde të shkruarit sot?

## TREGOJINI PUNËN NJËRI-TJETRIT

Në një klub shkrimtarësh është shumë e rëndësishme që të gjithë të ndiheni rehat dhe të sigurt kur i tregoni njëri-tjetrit punën. Si me çdo aktiviteti krijues, të shkruarit të krijon një ndjenjë shumë personale, dhe të gjithë jemi të ndjeshëm kur ua tregojmë shkrimet të tjerëve.

Lëre vetveten të krijojë konfidencën e duhur me kalimin e kohës, dhe tregohuni pozitivë me njëri-tjetrin kur ndani shkrimet me njëri-tjetrin. Duhet të dini se n.q.s. nuk dëshironi, nuk është e thënë t'ua tregoni të tjerëve punën tuaj sa herë që takoheni.

Kur ia tregoni shkrimet tuaja njëri-tjetrit, tregohuni të kujdesshëm dhe konstruktivë. Është e rëndësishme të thoni se çfarë mendoni për shkrimin. Është mirë që fjalinë ta filloni me “Më pëlqeu mënyra se si...” ose “Kjo më kujtoi diçka...”. Drejtoni edhe pyetje. “Mund të shpjegosh pjesën kur...” ose “Çfarë të pëlqen më shumë në shkrimin tënd?” “Për çfarë nuk je plotësisht i sigurt?”, të gjitha këto mund të nxisin diskutime të dobishme. Për të dhënë mendime të mira, duhet të jesh i matur dhe dëgjues i mirë.

Ndoshta që në takimin e parë mund të keni shkrime që doni t'i ndani me njëri-tjetrin, nëse ndodh kështu tregohuni të paanshëm dhe lejojini secilit të njëjtën hapësirë kohore për të folur për atë që kanë shkruar. Lërinë pjesëtarët të lexojnë punën e tyre me zë të lartë, ose nëse nuk ndjehen të lirshëm ta lexojnë vetë, sugjero që në vend të tyre ta lexojë dikush tjetër. Një mënyrë tjetër për t'u treguar të tjerëve shkrimet e tua është t'i fotokopjosh ato e t'ua shpërndash. Zhvilloni disa lojëra me shkrim, dhe nëse dëshironi

dikush mund të lexojë shkrimin e krijuar në lojë. Provoni të shkruani diçka sa herë që takoheni.

## LOJËRA ME SHKRIM PËR GRUPMOSHËN TUAJ

### KUSH/ÇFARË/KU/KUR

Si grup, krijoni një listë me 6 emra njerëzish, 6 profesione (grabitës bankash, aktor, hidraulik, shtëpiake e dëshpëruar...), 6 epoka në histori (dje, viti 1066, viti 2054, 10 më pas...) dhe 6 vende (Franca, dollapi i kuzhinës, planeti Mars, foleja e një zogu...). Shkruajini të gjitha listat diku ku mund të shihen nga të gjithë, ose shkruajini në letër individualisht. Keni 10-15 minuta për të zgjedhur një fjalë nga secila kolonë dhe t'i kombinoni ato në një tregim.

### MERR DY

Me fshehtësi, zgjidhni dy personazhe shumë të njohura nga TV ose filmat dhe kombinoni ata në një skenar të ndryshëm nga ata ku gjenden zakonisht, më pas pjesa tjetër e grupit mund të gjejë se kush janë këta personazhe kur t'u lexosh tregimin me zë të lartë. për shembull, Peggy Mitchell dhe Rhett Butler e gjejnë veten në mes të xhunglës. Çfarë ndodh? Si mbërritën aty? Çfarë do të bënte Peggy po të ishte në xhungël? Caktoni një kohë prej 20 minutash për të shkruar diçka.

### USHQIM, I MIRI USHQIM

Me radhë, sillni nga një objekt interesant ushqimor dhe për rreth 10 minuta shkruani diçka për të duke përdorur të gjitha shqisat sa më shumë të jetë e mundur. Nuhateni, shijojeni, shikojeni, prekeni, dëgjojeni (nëse bën zhurma, siç bën uji me gaz për shembull). Çfarë kujtimesh ju vijnë në mendje?



# Bookbite